



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO**  
**KOMUNA E DRAGASHIT**  
**DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ**



Datë: 18.06.2024

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA**  
**Komuna e Dragashit**  
**Opština Dragaš**

02 Nr. Br. 400/01-11968/24  
18.06.2024  
**Dragash - Dragaš**

## PROCESVERBAL

**Dëgjimi buxhetor me drejtorë të shkollave, pedagogë, punëtorë  
arsimorë dhe punëtorë shëndetësorë për  
Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027  
I mbajtur më 14.06.2024 (e premte)  
VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash**

Dëgjimi buxhetor me drejtorë të shkollave, pedagogë, punëtorë arsimorë dhe punëtorë shëndetësorë për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027 është mbajtur sipas Kalendarit të dëgjimeve buxhetore, të publikuar në uebfaqen zyrtare dhe Facebook më datën 28.05.2024.

### Kalendari i publikuar në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/ep-content/uploads/sites/12/2024/05/Kalendari-i-dëgjimeve-buxhetore-1.pdf>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/ep-content/uploads/sites/12/2024/05/Kalendari-i-dëgjimeve-buxhetore-2.pdf>

### Kalendari i publikuar në Facebook-un zyrtar:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/1N6ZuTk1eXbl3djf/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/2R15ACD7YRQs76rk/>

### Njoftimi në uebfaqen zyrtare:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/ep-content/uploads/sites/12/2024/06/Njoftimi-2.pdf>

Dëgjimi buxhetor ka filluar në ora 11:23 dhe ka përfunduar në ora 11:45.

Në këtë Dëgjim buxhetor kanë qenë prezentë 41 pjesëmarrës, prej tyre 33 meshkuj dhe 8 femra.

Hapjen e takimit e ka bërë nënkryetari i Komunës, Resul Fetahu, i cili i ka përshëndetur të pranishmit në emër të kryetarit dhe i ka falënderuar për pjesëmarrjen në takim.

**Qamil Kolloni, drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim:** Përshëndetje të gjithë ju të pranishëm! Do të mundohem të jem sa më i shkurtër dhe të bisedojmë shtruar. Përpo që do ta elaborojmë KAB-in, mund të diskutojmë edhe për çështje në vazhdimësi. KAB- është i hartuar konform Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike të Kosovës, e cila është e paraparë në kuadër të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë. Kjo Kornizë nënkupton rregullat të cilat i dërgon Qeveria nëpër komuna, ku i dërgon limitet minimale dhe maksimale të shpërndarjes apo ndarjes së buxhetit. Politikat e veta, Qeveria i përcjell përmes KAB-it nëpër komuna, ku përpos Grantit të përgjithshëm përcakton dhe grantet specifike në arsim dhe shëndetësi. E mira e këtij buxheti apo KAB-it, është se kemi një rritje progresive të buxhetit. Në krahasim me vitin 2024, buxheti i Komunës së Dragashit ka rritje në vlerën e shtuar prej 761,247 euro. Granti i Përgjithshëm i Qeverisë është 7,135,380 euro, Granti Specifik për Arsimin është 3,705,015 euro. Granti për Shëndetësi është 1,480,765 euro. Dhe realisht, Granti i Qeverisë është 12,321,160 euro. Të hyrat vetanake të parapara për vitin 2025 janë 551,054 euro. Pra, buxheti në total për vitin 2025, e kemi fjalën buxheti preliminar 12,872,214 euro. I gjithë ky buxhet është i shpërndarë në programe. Në qoftë se dëshironi, ne mund të shkojmë edhe për secilën zyrë veç e veç, por mendoj se do të ju kishte marrë më shumë kohë dhe nuk e di sa do të ishte në interesin tuaj që t'ju harxhojmë kohën. Prandaj, do të shkojë në ndarjet kryesore buxhetore, të cilat janë Pagat dhe Mëditjet, Investimet Kapitale, Mallrat dhe Shërbimet, dhe janë Shpenzimet Komunale, dhe gjithashtu janë edhe Subvencionet, që janë interes i përgjithshëm i Komunës. Prandaj, unë do të shkoj ta diskutojmë ndarjen e përgjithshme për vitin 2025. Pra, sipas Qarkores Buxhetore, na janë pranue 758 punëtorë në total në Komunën e Dragashit. Prej tyre, për Paga dhe Mëditje i kemi shumën prej 5,844,424 euro. Për Mallra dhe Shërbime kemi ndarë 1,530,342 euro. Shpenzime Komunale kemi paraparë 400 mijë euro, Subvencione 400 mijë euro, dhe Investime Kapitale kemi paraparë 4,714,443 euro. Në total kur mblidhen, thamë se shuma është 12,872,214 euro. Çfarë kemi paraparë në KAB, që do të ishte në interes? Te kjo rritje buxhetore realisht kemi një shqetësim, sepse në Qarkoren e Parë

Buxhetore na kanë ardhë shkurtime në stafin e punës në arsim diku për 90 punëtorë. Po shpresojmë se kjo do të jetë një gabim, për arsye se mjetet i kemi, dhe në anën tjetër kemi edhe shkurtime në vendet e punës në arsim. Duke i pas parasysh investimet kapitale, të cilat janë krye vitet e fundit, kemi qenë të detyruar që këtë vit të kërkojmë kode të reja të vendeve të punës. Për këtë arsye, investimet kapitale kanë dhënë rezultate. Kemi kërkuar që të na lejohen nga Ministria, për stadiumin në Dragash, dy vende për stadiumin në Blaç, dhe një vend për stadiumin në Plavë. Sa i përket arsimit, në dhjetë shkolla kemi paraparë nga një punëtorë që do të jetë i angazhuar te qendrat në komunitet. Shpresojmë që në vitin 2025 ta realizojmë këtë. Përpos punëtorëve që – siç e dini – pas hapjes së qendrave me bazë në komunitet në Bresanë, janë angazhues disa punëtorë. Sa i përket shumës për investime kapitale, unë mendoj se kemi një numër të madh të projekteve dy dhe trivjeçare të cilat i kemi në zhvillim e sipër. Nëse jeni të interesuar, ne mund të shkojmë edhe t'i lexojmë, por besoj se do të na marrë shumë kohë. Sa i përket shkollave dhe shëndetësisë, , realisht, vitin e kaluar mbi 63 mijë euro janë investue në shëndetësi, dhe thujse 90% të renovimit të objekteve shëndetësore kanë marrë fund, dhe është një pjesë bukur e vogël që gjatë këtij viti dhe vitin tjetër do të kryhen. Besoj që për vitin 2025 do të kemi shumë pak nevojë për intervenime në infrastrukturën e shëndetësisë. Gjithashtu edhe të shkollat. Problemet kyç janë se investimet nëpër shkolla po na krijojnë shpenzime të tjera. Për shembull, prej druve po kalojmë në energji elektrike ose në naftë. Prandaj, mendoj se me politikat të cilat është duke i përcjellë Qeveria në vija të trasha, çojnë në një zhvillim progresiv. Kur themi 4,714,000, ne shpresojmë që vitin tjetër – nga Granti i Performancës dhe nga Auditimi i Jashtëm kemi marrë vlerësimin e mirë – shpresojmë që edhe për gjysmë milion euro do të kemi rritje në investime kapitale. Një problem që po na paraqitet, sa do të kemi kompani të cilat do t'i kryejnë punimet në terren. Vitet e fundit, disa projekte janë ritenderuar nga dy-tri herë, për shkak se nuk ka kompani të mjaftueshme që t'i marrin punimet. Prandaj, unë nuk dua t'ju marr edhe shumë kohë, do të ishte mirë që ta hapim debatin, besoj se ju do të bëni edhe pyetje dhe do të kërkonit sqarime.

**Shukri Nebiu, drejtor i ShML “Ruzhdi Berisha”:** Përshëndetje nënkryater, përshëndetje drejtor, përshëndetje drejtorë të shkollave dhe ju tjerë që jeni të pranishëm këtu! Unë si drejtor i Shkollës së Mesme “Ruzhdi Berisha” në Dragash, desha të pyes për vitin 2025, nëse është regjistruar diçka për Shkollën e Mesme “Ruzhdi Berisha” nga investimet kapitale. Para dy viteve është ndarë një buxhet për investimet kapitale, për sanimin e banjove të nxënësve, ku është krye ajo, mirëpo kanë mbetur në gjysmë të punës dy kabinetet ku është filluar puna dhe nuk punohet aty. Faleminderit!

**Qamil Kolloni:** Drejtor, faleminderit për pyetjen! Sa i përket Shkollës “Ruzhdi Berisha”, ti bëre kërkesën për çka keni nevojë në shkollë, unë besoj se këtë vit, për vitin 2025, në bazë të kërkesës që do ta paraqesësh, besojmë që do të jetë e realizueshme. Në aspektin monetar, sepse problemin e ekzekutimit dhe çështjeve tjera duhet të përgjigjen menaxherat. Besoj se për vitin tjetër kemi mjete të mjaftueshme, sa i përket investimit dhe renovimit të shkollave. Kemi fond të mjaftueshëm dhe nuk kemi më shumë shkolla ku ka nevojë për shumë intervenime. Përderisa nuk e ndryshojmë strukturën për investime tjera zhvillimore, ky Grant Specifik për Arsimin duhet të harxhohet në arsim, andaj unë besoj se do të ketë mjete. Ky është një buxhet preliminar dhe deri në shtator të gjitha kërkesat tuaja mund t’i shohim në bazë të buxhetit se si mund t’i evidentojmë. Megjithatë, unë e mora si kërkesë dhe do të bisedoj me drejtorin e Arsimit, dhe të shohim se ku qëndron problemi. Ka mundësi që ka vështirësi me kompanitë të cilat bëjnë ekzekutimin e atij projekti. Ta shohim se si qëndron situata dhe besoj që, bashkë me drejtorin e Arsimit do ta bëjmë një vizitë, dhe e shohim bashkërisht qysh mund të dalim prej kësaj situatë. Me e bo më të mirën të mundshme, sepse në këtë shkollë të mesme e kemi, nuk kemi tjetër, dhe në qoftë se nuk jemi në gjendje edhe kësaj me iu përgjigj, atëherë...

**Jeton Qengaj, OJQ “AVOKO”:** Ju përshëndes të gjithëve! Drejtor, unë e pata një interesim. Është një shkollë e mesme në fshatin Shajne që është bo, a keni pa ndonjë mundësi për me funksionalizue? Në momentin që ajo shkollë nuk i plotëson kriteret për shkollë të mesme apo për shkak të largësisë, çka mundet me u bo për me iu ndryshue destinacioni. U bënë dhjetë vite e shumë më tepër e ajo nuk është funksionale. Kështu që, ai objekt mundet me krye punë për shumë sende tjera dhe me i pru të ardhura Komunës së Dragashit. Faleminderit!

**Qamil Kolloni:** Në fillim kur kemi ardhë, qëllimi ynë ka qenë që të bëjmë ndryshime në Gjimnaz dhe në aspektin e infrastrukturës së Komunës së Dragashit. Ta bartim Komunën dhe ta ndërtojmë te ish-DKA-ja, dhe kemi marrë iniciativën bashkë me kryetarin, kemi vizitue edhe Shkollën e Mesme. Ka qenë ish-drejtori, Selim Kryeziu. Kemi vizituar edhe qendrën atje lart. Janë disa probleme të cilat noshta nuk do të ishin mirë për këtë debat me i diskutue, po është mirë që të jenë të njoftuar të gjithë. Ajo shkollë ka edhe probleme politike, edhe probleme teknike.

Problemi politik qëndron se ajo është një shkollë e papranuar teknikisht. Në kur kemi desht me e barte Gjimnazin nalt dhe me e funksionalizue, është dashtë me shkue me procedura të ndryshimit të emrit, që na ka shkaktue vështirësi, për arsye se shkollës po ia hekim një emër që ia kemi vu dhe po ia ndërrojmë një emër tjetër, na shkakton probleme politike. Dhe nuk kemi pas guximin të bëjmë një këso ndryshimi. E dyta: Ajo shkollë është e ndërtuar shumë herët dhe nuk është e pranuar teknikisht.

Mungesa e saj që nuk është e pranuar teknikisht, ne kemi ndërmarrë disa masa. Kemi marrë si pronë e kemi regjistruar dhe e kemi nën mbikëqyrje, e paguajmë personelin për mbikëqyrje dhe e kemi lëshuar, sikur kur ja japish Komunës me qira, për me mund me e mbrojt si kapital. Përndryshe, ligjërish, tjera vendime nuk kemi mundësi me marrë. E shfrytëzojmë, jemi duke e mbajtur Panairin. Jemi munduar me i evitue prishjet e ujit që i ka pas. Salla e cila është e ndërtuar është tërësisht e prishur, ajo pjesa aneks, për shkak të shiut, që do shumë mjete për renovim. Prandaj, kjo gjendje është kështu si është. Ne do të bëjmë përpjekje deri në një moment kur ajo do ta na bartet si pronë, dhe do të kemi ligjërish të drejtë të operojmë. Përderisa nuk është e pranuar, nuk kemi mundësi teknike që të operojmë. Në një formë, e kemi marrë nën menaxhim që të mos humb, për arsye se vlera e saj është bukur e madhe. Vullneti edhe dëshira kanë qenë. Sa i përket barjtes, ma merr mendja se me drejtorin e shkollës, me drejtorin e Drejtoratit, me drejtorët e shkollave, duhet me ardhë në një vendim të përbashkët. Aty duhet të mendojmë racionalisht, a ka nevojë apo jo, duhet të bëhen disa analiza. Në qoftë se DKA-ja dhe drejtorët e shkollave vendosin për një gjë të tillë, atëherë si ekip politik ne do të fillojmë, me Kuvendin, me i zbatue dhe me i marrë vendimet për të operuar më tutje.

**Resul Fetahu:** A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Nëse nuk ka, atëherë ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim!

**Linqet e lajmeve për mbajtjen e dëgjimit buxhetor, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:**

**Në uebfaqe:**

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/news/sot-u-mbajt-degjimi-buxhetor-per-kab-in-me-punetoret-e-arsimit-dhe-shendetesise/>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/sr/news/danas-je-odrzana-budzetska-rasprava-sa-direktorima-skola-predavacima-prosvjetnim-radnicima-i-zdravstvenim-radnicima/>

**Në Facebook:**

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/DFmR24ZB9wEz39C8/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/55D2DyMYRYSZ1vWH/>

**SHTOJCË:** *Lista e pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor dhe fotografitë*

02 Nr. Br. 400/01-11968/24  
 14.06.2024  
 Dragash, Dragaš



REPUBLIKA E KOSOVËS  
 REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO  
 KOMUNA E DRAGASHIT  
 DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Data/Datum: 14.06.2024

Vendi/Mesto: Salla e Kuvendit Komunal -- Dragash/ Sala Skupštine Opštine - Dragaš

LISTA E PJESËMARRËSVE NË DËGJIMIN BUXHETOR  
 ME DREJTORË TË SHKOLLAVE, PEDAGOGË, PUNËTORË  
 ARSIMORË DHE PUNËTORË SHËNDETËSORË  
 PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE 2025 – 2027

LISTA UÇESNIKA NA RASPRAVA BUDŽETA SA DIREKTORIMA  
 ŠKOLA, NASTAVNICIMA, PROSVETNIM RADNICIMA I  
 ZDRAVSTVENIM RADNICIMA  
 ZA SREDNJOROCNI BUDŽETSKI OKVIR 2025 - 2027

Nr. Br.	Emri dhe Mbiemri Ime i Prezime	Vendbanimi Prebivalište	Etnia Etnička pripadnost	M M	F Ž	Nënshkrimi Potpis
1	Facilit Bakllari	Bellëgrad	shqiptar	M		
2	Shukri Uebija	Blac	shqiptar	M		
3	Lez Elezi	Corrut	shqiptar	M		
4	Behar Guri	Kosovë	shqiptar	M		
5	VADIN ADEMI	brodosanë	shqiptar	M		
6	Flurim Rengy	Dragash	shqiptar	M		
7	Behar Shala	Brezne	shqiptar	M		
8	ARBEH Skender	Dragash	shqiptar	M		
9	Velmir Vehapi	Thajme	shqiptar	M		
10	Femi Kojbe	Rreuc	shqiptar	M		
11	Shkëlqim Huloj	Plavë	shqiptar	M		
12	Arifim Bajraktari	Plavë	shqiptar	M		
13	Veton Kramiqi	Brezne	shqiptar	M		
14	Votim Beqiri	Xerxe	shqiptar	M		
15	Zijaolir Ualeji	Blac	shqiptar	V		
16	HASIM-SAICI	TERCI	shqiptar	M		
17	Jasni Bajrami	Repaz	Bosnjak	M		
18	Elvir Shijazi	Kruševo	Bosnjak	M		
19	Bajrami Hodaj	Restekaj	Shqiptar	M		
20	Shaban Skellaj	Burç	shqiptar	M		
21	SHAD TOSUNI	RAPÇA	BOSNJAK	M		
22	Donan Shenderaskaj	Brodi	Bosnjak	M		

23	Abuheri Bojda	Brod.	Bosnjak	M		
24	Florica Hyseni	Shqipe	Shqiptar	M		
25	ELI QAFLESHI	BELLOBRAD	SHQIPTAR	M		
26	Walter Myrtazani	Zapll. Bred	Shqiptar	M		
27	<del>Agon BASHAKU</del>	<del>Bellobrad</del>	<del>Shqiptar</del>	<del>M</del>		
28	Kaltrina Crossiq	Brezne	Shqiptare	F		
29	Jeton Mengay	Ilaznik	Shqiptar	M		
30	Elise Pashit	Shayne	shqiptare	F		
31	Semine Nisiri	Shayne	Shqiptare	F		
32	Niera Piraj	Pilave	Shqiptare	F		
33	Gendara Spahiu	BUCE	shqiptare	F		
34	Gresa Hasani	Brod	shqiptare	F		
35	Sherhete Bojoxhiu	More	Shqiptar	F		
36	ELA QAFLESHI	BELLOBRAD	SHQIPTARE	F		
37	ZENI KRASHI	BUCE	SHQIPTAR	M		
38	Armoni Bercisha	BUCE	SH.	M		
39	RESUL FETAHU	KUK	Shqiptar	M		
40	KADRI AREGHI	BREJAN	SHQIPTAR	M		
41	FARI KULLANI	KOSAR	shqiptar	M		
42						
43						
44						
45						
46						
47						
48						
49						
50						
51						
52						
53						
54						
55						
56						
57						
58						
59						
60						
61						
62						
63						
64						
65						
66						
67						
68						
69						

From President William Jefferson Davis

